

KONTRATË

Numri i kontratës:¹ 622-24-6589-5-2-1/C1469

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

" **EdiBau- ing** " **SH.P.K., UKË BYTYÇI PN, PRIZREN**, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Punimi terrenit sportiv dhe rrethojës së oborrit në SHFMU Naim Frashëri Kobaj-Prizren me numër identifikues: **622-24-6589-5-2-1**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Punimi terrenit sportiv dhe rrethojës së oborrit në SHFMU Naim Frashëri Kobaj-Prizren**

No.	Lot
1	Punimi terrenit sportiv dhe rrethojës së oborrit në SHFMU Naim Frashëri Kobaj-Prizren

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **144,738.10 € (njëqind e dyzet e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e tet euro e dhjetë cent)**.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

(Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës së vendit)

[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.


dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën ² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Isa Osmankaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	15.08.2024
Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	Bujar Spahija
Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:	
Data:	15.08.2024
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 622-24-6589-5-2-1/C1469

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% i vlerës së kontratës me vlefshmëri prej 10 muaj kalendarik .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 03 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit .

Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë .dy dit pas hyrjes në fuqi të kontratës
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 200 ditë pune nga data e hyrjes në fuqi të kontratës
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Mbikqyrës i drejtpërdrejt i menaxherit të kontratës do të jetë: Luljeta Veselaj Gutaj Drejtoreshë në DASH Menaxheri i Kontratës është: Veron Aliu IDA në DASH
Parapagimi		Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: e vlerës se kontratës.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është 2 vite kalendarike pas pranimit përfundimtar të punimeve.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Neni 42 42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periodha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë: a) ose vendim nga gjyqi; b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK. 43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

OBJEKTI: Rregullimi i ambientit te oborrit ne
SH.M.U. " Naim Frasheri " KOBALJ - PRIZREN

A	PUNËT E PREGATITORE				
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Pergaditja e kompanise per fillimin e punimeve, bartja e mjeteve te punes dhe paisjeve tjera te nevojshme per pune.	paushall	1.00	400.00	400.00 €
2	Furnizimi me material si dhe shenimet adekuate/te nevojshme, si dhe marrja e masave adekuate per siguri ne pune.	paushall	1.00	200.00	200.00 €
3	Rrethimi i punishtes	paushall	1.00	300.00	300.00 €
Total :					900.00 €

B	PUNËT E DEMOLIMIT				
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Demolimi i rrugices nga betoni dhe bartja e mbeturinave deri ne deponine me te afert.	m ²	40.00	5.00	200.00 €
2	Demolimi i kubzave dhe bartja e mbeturinave deri ne deponine me te afert.	m ²	200.00	3.00	600.00 €
3	Demolimi i ansoreve dhe bartja e mbeturinave deri ne deponine me te afert.	m'	100.00	3.00	300.00 €
Total :					1,100.00 €

C	PUNËT E ZHAVORIT				
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Ngjeshja e dheut me mekanizem cilindër deri në arrijtjen e kompaktësise së nevojshme të dheut për nivelizimin e terenit.	m ²	1750.00	0.50	875.00 €



2	Furnizimi me material si dhe shtruarja dhe ngjeshja e shtreses se zhavorit per nivelizimin e komplet pjeses se oborrit sipas fraksioneve te parapara me projekt fraksion 0/125mm, t=50 cm .	m ³	720.00	13.00	9,360.00 €	✓
3	Furnizimi me material si dhe shtruarja dhe ngjeshja e shtreses se zhavorit per nivelizimin e komplet pjeses se oborrit sipas fraksioneve te parapara me projekt fraksion 0/63mm, t=30cm .	m ³	450.00	13.00	5,850.00 €	✓
Total :					16,085.00 €	✓

D	PUNËT E BETONIT DHE ARMIMIT					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma	
1	Ngjeshja e dheut me mekanizem cilindër deri ne arrijten e kompaktësise se nevojshme te dheut per ndertimin e themeleve te fushes sportit.	m ²	810.00	0.50	405.00 €	✓
2	Furnizimi me material si dhe shtruarja dhe ngjeshja e zhavorit ne FR III nen themelet e rrethojës se fushes se sportive .	m ³	15.00	13.00	195.00 €	✓
3	Furnizimi me material si dhe betonimi i shtreses rrafshuese nga betoni i paarmuar C-15/20	m ³	4.50	75.00	337.50 €	✓
4	Furnizimi me material si dhe betonimi i themeleve te veqara te rrethojës se fushes sportit me beton C-25/30.	m ³	35.50	80.00	2,840.00 €	✓
5	Furnizimi me material si dhe betonimi i cokulles se rrethojës me beton C-25/30.	m ³	16.50	80.00	1,320.00 €	✓
6	Furnizimi me material, prerja dhe lakimi i armaturave S-400/500, sipas detajeve te armimit. Per punimin e themelit dhe cokulles se fushes sportit.	kg	5630.00	0.90	5,067.00 €	✓
Total :					10,164.50 €	✓



PUNET E MURIT RRETHUES					
E	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Germimi i dheut te kategorise se VII dhe VIII gur shkembor (ne rast nevoje te perdoret edhe minimi) dhe transporti i dheut deri ne deponi.	m³	102.00	3.00	306.00 €
2	Formësimi dhe ngjeshja e nenbazes se themlit te murit rrethues.	m	240.00	1.00	240.00 €
3	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit 0-63mm nen bazen e themlit me trashësi t=10cm	m³	15.20	13.00	197.60 €
4	Furnizimi,transporti dhe betonimi i themeleve shiritore te murit rrethues nga betoni i thjeshtë C15/20 , ne çmim te llogaritet vendosja e pahive dhe mirmbajtja e betonit. Sipas detalit te dhënë.	m³	12.50	75.00	937.50 €
5	Furnizimi, transporti dhe betonimi i themeleve shiritore te murit rrethues nga betoni i armuar C25/30 . Sipas detalit te dhënë.	m³	77.00	80.00	6,160.00 €
6	Furnizimi, transporti dhe betonimi i cokulles te murit rrethues nga betoni i armuar C25/30 deri ne lartesi h=100cm, muri te punohet me kaskada (disnivele) per arsye te terenit te pjerret. Sipas detalit te dhënë.	m³	67.00	80.00	5,360.00 €
7	Furnizimi, transporti, lakimi dhe montimi i armatures se brinjezuar S-400/500 per themele, murin rrethues. Sipas detalit te dhënë.	kg	15850.00	0.90	14,265.00 €
8	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rrethojes nga celiku ne murin rrethues ne lartesine 150 cm sipas detalit ne projekt, duke u vendosur ne shtylla katrore 60x60x2.5 mm. Shtyllat metalike vendosen cdo 3m distance, dhe profile gjatesore 20x20 mm, ndersa terthore 40x20 mm me trashesi ne murit min. 2.0mm, materiali celik me ngjyre te zeze, te vendosen kapaket e plastikes.	m'	240.00	80.00	19,200.00 €



9	Furnizimi dhe vendosja e derës rreshqitese te oborrit me gjeresi 500cm dhe lartesi 200cm, nga materiali celik.	cope	1.00	600.00	600.00 €	✓
10	Furnizimi dhe montimi i derës hyrese ne oborr me gjeresi 120 cm dhe lartesi 200 cm, nga materiali celik	cope	1.00	250.00	250.00 €	✓
Total :					47,516.10 €	✓

F	PUNËT E ASFALLTIT					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma	
1	Furnizimi me material si dhe shtruarja dhe ngjeshja e shtreses se zhavorit sipas fraksioneve te parapara me projekt fraksion 0/60mm , t=30 cm ne pjesen e fushes se sportive dhe ngjeshja me cilinder.	m³	243.00	13.00	3,159.00 €	✓
2	Furnizimi me material si dhe shtruarja dhe ngjeshja e shtreses se zhavorit sipas fraksioneve te parapara me projekt fraksion 0/31.5mm , t=15 cm ne pjesen e fushes se sportive dhe ngjeshja me cilinder.	m³	121.50	13.00	1,579.50 €	✓
3	Furnizimi, bartja si dhe punimi i rërës së imët dhe nivelzimi i sajë prej gurit të thyer zhavorit 4-8mm me trashësi t=10cm.	m³	81.00	13.00	1,053.00 €	✓
4	Furnizimi , shtrirja, planifikimi dhe kompaktimi (me mjete adekuate) i shtreses se Asfaltbetonit AB-0/16mm, t=8 cm.	m²	810.00	15.00	12,150.00 €	✓
Total :					17,941.50 €	✓

G	PUNET E KUBZAVE					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma	
1	Germimi i terenit te kategorise se VII dhe VIII , thyerja e gureve shkembor me qekan ne vendet e nevojshme per nivelizimin e terenit dhe trasnporti i dheut deri ne deponi.	m³	390.00	3.00	1,170.00 €	✓
2	Formësimi dhe ngjeshja e baze se terenit te oborrit ne shtresa pas shtrirjes se zhavorit.	m²	1000.00	0.50	500.00 €	✓

3	Furnizimi me material si dhe shtruarja dhe ngjeshja e shtreses se zhavorit sipas fraksioneve te parapara me projekt fraksion 0/60mm , t=30 cm ne pjesen e kubzave .	m ³	300.00	13.00	3,900.00 €	✓
4	Furnizimi me material si dhe shtruarja dhe ngjeshja e shtreses se zhavorit sipas fraksioneve te parapara me projekt fraksion 0/31.5mm , t=15 cm ne pjesen e kubzave dhe ngjeshja me cilindër.	m ³	150.00	13.00	1,950.00 €	✓
5	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës rrafshuese me rere te imet nga gurit të thyer fraksion 0-4mm, me trashësi të shtresës t=10 cm ne pjesen e kubzave	m ³	100.00	13.00	1,300.00 €	✓
6	Furnizimi dhe vendosja e gureve skajorëve nga betoni I klases C25/30 ne cmim te perfshihen te gjitha punimet deri ne perfundim te pozicionit	m'	270.00	12.00	3,240.00 €	✓
7	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e kubëzave nga betoni i klases C25/30 me t=8cm . Ne pozicion përfshihet edhe mbushja e fugave me rërë.	m ²	1050.00	15.00	15,750.00 €	
Total :					27,810.00 €	✓




H	PUNET E ARMATURES DHE KONSTRUKSIONIT METALIK (Rrethoja e tushes sportit)				
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Furnizimi me material si dhe vendosja e rrethojës. Rrethoja është nga konstruksioni metalik (profilet metalike) si dhe mbushja me rrjete qeliku. Te punohet sipas vizatimit. Shtyllat janë 80x80x3mm -te mbyllen me kapakë ne vendet ku ka nevojë, kater horizontalet kryesore janë 40x40x3mm . Mbushja(rrjeta) te jete Ø8 15/15 cm . Te parashihet ankerimi ne beton sipas vizatimeve. Te parashihet ngjyrosja e rrethojës ne dy shtresa sipas standarteve si dhe ngjyrosja kunder korezionit, nuancen e ngjyres e percakton organi mbikeqyres. Lartesia e rrethojës është h=550cm 50 cm e ankeruar ne themelin BA. Te punohet sipas detaleve te paraqitura ne projekt.	m'	125.00	70.00	8,750.00 €
2	Furnizimi dhe vendosja e derës hyrese ne fushe te sportit me gjeresi 200cm dhe lartesi 210cm, nga materiali celik sipas projektit.	copë	1.00	250.00	250.00 €
Total :					9,000.00 €

I	PUNË TË NDRYSHME				
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Germimi i dheut te kategorise se III dhe IV , ne thellsi h=30cm tek pjesa e gjelbrimit dhe trasnporti i dheut deri ne deponi.	m ³	565.00	3.00	1,695.00 €
2	Furnizimi, transporti, shtruarja , përpunimi, rrafshimi me kujdes si dhe ngjeshja e dheut humusor ne pjesën e planifikuar të gjelbrimit.	m ³	435.00	10.00	4,350.00 €
3	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e barit per parqe me rritje te shkurte, duke llogaritur afersisht 4kg/ari, duhet llogaritet edhe ujitja e barit gjat mbjelljes.	m ²	1444.50	3.00	4,333.50 €
4	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e drunjeve dekorativ të llojit Fraxinus Globosa me substart te vetin	copë	5.00	50.00	250.00 €

5	Furnizimi dhe montimi i ulëseve të oborrit.	copë	4.00	100.00	400.00 €	✓
6	Furnizimi dhe instalimi i koshave të mbeturinave, ankerimi i tyre për bazamentin e betonit.	copë	5.00	50.00	250.00 €	✓
7	Furnizimi me material si dhe vendosja e portave për futboll shkollor, portat të jenë nga metali, të jenë levizese me dimensione 3x2m, të ketë të vendosur rrjetin adekuate.	copë	2.00	300.00	600.00 €	✓
8	Furnizimi me material si dhe ngjyrosja e vijave për zhvillimin e lojës së futbollit, këto tri vija do të jenë me nuanca të ndryshme, të punohen sipas standardeve.	paushall	1.00	500.00	500.00 €	✓
Total :					12,378.50 €	✓

J	PUNËT E ELEKTRIKËS RRYMA E FORTË				
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Furnizimi dhe montimi kabllor elektrik PP00 5x4mm ² për furnizim me rrymë të reflektorave nga shkolla deri në tabelen KK.	m	32.00	5.00	160.00 €
2	Furnizimi dhe montimi në mur i kuadrit kabllorik për kyçje KK me rrymë nominale 63 A. Tipi i kuadrit dhe karakteristikat e tij duhet të përgjigjen kushteve të ndërmarrjes elektrodistributive. Komplet me zbarrë për barazimin e potencialit dhe për shqyrtim dhe i gatshëm për punë.	copë	1.00	50.00	50.00 €
3	Furnizimi dhe montimi i siguresave automatike C40 A së bashku me bazën për montim	copë	1.00	30.00	30.00 €
4	Furnizimi dhe montimi i ndërprerësit monofazë për reflektora	copë	1.00	20.00	20.00 €
5	Materiali tjetër montues (zbarra, borna rendore, përçues për lidhje, etj)	paushall	1.00	50.00	50.00 €
6	Furnizimi dhe montimi i kabllor së bakrit H05VV-F- 3x2.5mm ² i cili përdoret nga kutijat shpërndarëse deri të REFLEKTORIT, i cili duhet të jetë i mbështjellur me gyp special që nuk e lejon depertimin e ujit.	m	265.00	2.50	662.50 €



7	Furnizimi dhe montimi i kontaktorëve dyëpolar CN16 për reflektorë	copë	8.00	10.00	80.00 €	✓
8	Furnizimi dhe montimi i reflektoreve për ndriçim, montimi në mbajteset speciale, reflektimi kah poshtë, IP 65, shtëpiza dy pjeseshe nga alumini i derdhur, me PANEL LED 200W.	copë	8.00	50.00	400.00 €	✓
9	Furnizimi dhe shtrirja e shiritit për tokezim 25X4mm	m'	130.00	3.00	390.00 €	✓
Total :					1,842.50 €	✓

REKAPITULLIMI			
A	PUNËT E PREGATITORE	900.00 €	✓
B	PUNËT E DEMOLIMIT	1,100.00 €	✓
C	PUNËT E ZHAVORIT	16,085.00 €	✓
D	PUNËT E BETONIT DHE ARMIMIT	10,164.50 €	✓
E	PUNËT E MURIT RRETHUES	47,516.10 €	✓
F	PUNËT E ASFALLTIT	17,941.50 €	✓
G	PUNET E KUBZAVE	27,810.00 €	✓
H	PUNËT E ARMATURËS DHE KONSTRUKSIONIT METALIK (Rrethoja e fushes Sportit)	9,000.00 €	✓
I	PUNË TË NDRYSHME	12,378.50 €	✓
J	PUNËT E ELEKTRIKËS RRYMA E FORTË	1,842.50 €	✓
	TOTAL	144,738.10 €	✓



AUTORITETI KONTRAKTUES

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, Remzi Ademaj, -20000, PRIZREN,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 622-24-6589-5-2-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: " **EdiBau- ing** " **SH.P.K., UKË BYTYÇI PN, 20000, PRIZREN, Kosovë**

E-mail: **edibauing@gmail.com**

Personi kontaktues: **Bujar Spahija**

Telefoni: **044/144454**

049/380600

Faxi:

Numri fiskal: **601597779**

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 622-24-6589-5-2-1

Titulli i kontratës: Punimi terrenit sportiv dhe rrethojës së oborrit në SHFMU Naim Frashëri Kobaj-Prizren

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Punimi terrenit sportiv dhe rrethojës së oborrit në SHFMU Naim Frashëri Kobaj-Prizren

3. Çmimi total i tenderit është:

144,738.10 EUR

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë **Euro**]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: **90** nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Policies me Nr. **129538**

Për **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **EdiBaU- Ing SH.P.K.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Punimi terrenit sportiv dhe rrethojës së oborrit në SHFMU Naim Frashëri Kobaj-Prizren.**

Nr. prokurimit: 622-24-6589-5-2-1

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **14,473.81€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **14,473.81€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 305 ditë kalendarike prej **14.08.2024** deri më **15.06.2025**

Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit të Garancionit, Siguruesit/Garantuesit i kalon e drejta për ta rimbursuar nga i Siguruari/Kontraktuesi shumën e paguar përfituesit, me të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore deri në përmbushjen e tërësishme të detyrimeve.

Data lëshimit: 14.08.2024

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.